



POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

- 1
- 2
- 3
- 4
- 5

Kronikë

Tiranë/ Vodhën 2.5 milionë lekë në një banesë në Sharrë, 3 të arrestuar dhe një në kërkim! Sekuestrohet një 'Maserati' (VIDEO)

Tre persona që vepronin si grup kriminal janë arrestuar nga blutë e Tiranës. Dhjetë ditë më parë ata vodhën një shumë parash dhe disa bizhuteri një shtëpi në zonën e Sharrës.

Vodhën 2.5 milionë lekë në një banesë në Sharrë, 3 të arrestuar dhe një në kërkim!



Watch on

[Sh] Redaksia
25 Gusht, 12:13 | Përditësimi: 25 Gusht, 12:39

Share Post



Tiranë - Tre persona që vepronin si grup kriminal janë arrestuar nga blutë e Tiranës si autorë të dyshuar të një banese në zonën e Sharrës 10 ditë më parë. Ndërkohë një tjetër është shpallur në kërkim.

Të arrestuarit **Leonard Sinani** 26-vjeç, **Kleand Tomja** 23-vjeç, **Mark Hila** 37-vjeç dhe personi në kërkim me inicialet A.B., përveç shumës së parave vodhën edhe disa bizhuteri me vlerë 500 mijë lekë.

Siç shihet edhe nga video e publikuar 'skifterët', me kapuç dhe të maskuar janë kapur 'mat' nga kamerat e sigurisë duke vjedhur në banesë.



LEXO EDHE:
Zjarr në malin e Dajtit në Tiranë, një avion në operacion për shuarjen e flakëve

Nga kontrollet e kryera në servisin në bashkëpronësi të A.B., dhe Mark Hilës në zonën e Astirit uniformat blu gjetën 1 armë zjarri, 3 krehra, 82 fishekë luftarak, 2 automjete mes tyre një 'Maserati' 1 motor dhe 2 palë targa automjesh.

Ndërkohë në banesën e 23-vjeçarit Kleand Tomja, u gjet dhe u sekuestrua 1 automjet dhe 55 000 lekë.

"Zbardhet vjedhja në një banesë në Sharrë, ku para 10 ditësh u morën 2 500 000 lekë dhe bizhuteri me vlerë rreth 500 000 lekë.

Si rezultat i hetimit intensiv të kryer nga shërbimet e Komisarariatit të Policisë Nr. 6, në koordinim me Prokurorinë, me qëllim zbardhjen e autorësisë dhe rrethanave të vjedhjes në banesën e shtetasit D. S., më datë 14.08.2026, u finalizua operacioni i koduar "Last Scheme", në kuadër të të cilit u vunë në pranga 3 nga autorët e dyshuar të rastit, konkretisht shtetasit L. S., 26 vjeç, K. T., 23 vjeç dhe M. H., 37 vjeç, si dhe u shpall në kërkim autori tjetër i dyshuar, shtetas A. B.

Në vijim të veprimeve operationale u krye kontroll në servisin për mjete, në bashkëpronësi të shtetasve A. B. dhe M. H., ku u gjetën 1 armë zjarri, 3 krehra, 82 fishekë luftarak, 2 automjete, 1 motomjet dhe 2 palë targa automjesh.

Më tej u krye kontroll në banesën e shtetasit K. T., nga ku u sekuestruan 1 automjet dhe 55 000 lekë.

Vijon puna për kapjen e shtetasit të shpallur në kërkim, si dhe vijon hetimi për dokumentimin e plotë të këtij rasti kriminal",njoftoi sot policia.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme.

Sqarim: Çdo person prezumohet i pafajshëm deri sa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë

Xh.K/E.H/Shqiptarja.com

TAG: vjedhje Tirane Leonard Sinani Kleand Tomja mark hila

Sa e vlerësoni këtë artikull? 5.0 / 5 (2 vlerësime)

LAJMET MË TË VLERËSUARA

Komente

Komento

Ndalohet repretësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Si ju duket plani i qeverisjes i paraqitur në Pogradec nga Rama?

24 Gusht, 21:21

Mirë Keq Nuk e di

Lajme të tjera



Jakin Marena: 'Vijat e kuqe' të SHBA, opozita dhe revolucionit që s'ndezi as nga 'Gaza'


Jakin Marena

25 Gusht, 19:10



Balla nxjerr pamje nga një vendgrumbullim mbetjesh në Spille: Bashkia Kavajë nuk merret me pastrimin! Do ndërhyjmë vetë, s'do presim Fisnikun

25 Gusht, 17:28



Gara për Tiranën/ Berisha: Primaret s'përfashtohen! Alimehmeti, personalitet i shquar! Kandidatura e Braçes? Luftë e brendshme në PS

25 Gusht, 13:57



Tiranë/ Goditi me qytën e pistoletës një person në një lokal në 'Don Bosko', arrestohet 37-vjeçari (EMRAT+VIDEO)

25 Gusht, 13:21




'Territoriaja'/ Demokratët kërkesë Këshillit Bashkiak: Nisni dëgjuesat në Tiranë! Banorët e Klosit: Jo bashkim me Matin! PS e PD përplasen në Elbasan

25 Gusht, 13:19




Tiranë/ Kontroll në burgun '313', të riut i gjenden 17 doza kokainë dhe 13 doza hokashë

25 Gusht, 12:58




Përmirësohet situata me zjarret, vetëm 6 vatra aktive! Vijon operacioni në Malin e Dajtit, flakë edhe në Shashicë të Vlorës! 'Qetësohet' Puka

25 Gusht, 09:32



Vendoret 2027/ Braçe: Do t'i shkoj deri në fund garës për Tiranën! Kandidati i PS të mos vijë me 'njoftim në mur', socialistët duhet të zgjedhin (VIDEO)

25 Gusht, 08:19



Burri rreh me shkop gruan në mes të protestës, përfundon në Komisarariat (VIDEO)

24 Gusht, 22:53




Ylli Pata

24 Gusht, 19:44



Mashtroi punonjësit në 2 biznese në Tiranë dhe vodhi një çantë brenda një tjetër subjekti, arrestohet 37-vjeçari (EMRI)

24 Gusht, 16:56



Videocall me imazhin e Bashkim Ulajt të krijuar me AI, si 3 të rinjtë në Tiranë mashtruan 70-vjeçarin kambist dhe i morën 100 mijë euro (VIDEO)

24 Gusht, 16:37

Lajmi i fundit



Zbulohet plani i BIA-s serbe për kompromentimin e Albin Kurtit, ja çfarë u gjet në telefonin e analistit të dyshuar për spiunazh!

25 Gusht, 21:42





× **[Sh]**
.com Lajmi i fundit



Zbulohet plani i BIA-s serbe për kompromentimin e Albin Kurtit, ja çfarë u gjet në telefonin e analistit të dyshuar për spiunazh!

25 Gusht, 21:42